

PROCESVERBAL
nga seanca e 45-të e Këshillit të Agjencisë
për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 21.12.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 45-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e dytë.

Z. Petrushevski në lidhje me propozimin e Rendit të ditës sqaroi se duhet të plotësohet me tri pika për të cilat anëtarët e Këshillit e kanë pranuar materialin nëpërmjet postës elektronike e-mail. Në këtë drejtim, ai propozoi që të shtohen këto tri pika para pikës Të ndryshme, përkatësisht si Pika e 17-të – Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike për Kablekall nga Kërçova, për shkelje të nenit 143 paragrafi (2) të LSHMAAV, me propozim –për informim të organit kompetent për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është kryer shkelje, Pika 18 – propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit Totall TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe Pika 19 - Propozim-informacion organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është kryer shkelja e tyre.

Anëtarët e Këshillit nuk ishin kundër këtij propozimi.

Z. Petrushevski po ashtu propozoi që për Pikat 2, 3 dhe 4, më pas për Pikat 7 dhe 8 dhe për Pikat 9, 10, 11 dhe 12, pasi kanë tematikë të ndërlidhur (të njëjtë) të ketë hyrje dhe diskutim të përbashkët, ndërsa votimi të jetë për secilën pikë në veçanti.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi korrigjimin e mëposhtëm të:

RENDIT TË DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 44-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 5.12.2022.
2. Propozim-plan vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2023.
3. Propozim-plan vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2023.
4. Propozim-program për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 (me Propozim-program të aktiviteteve të planifikuara dhe

Propozim-plan financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023).

5. Propozim-vendim për dhënie ndihmë financiare (donacion) për transmetuesit për vitin 2023, në vlerë prej 25% nga kompensimi për leje.
6. Propozim për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes të SHTR TV Iris nga Shtipi.
7. Propozim – plan vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMA-së) për vitin 2023.
8. Propozim – plan vjetor për vlerësim të rreziqeve nga korrupsioni të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMA-së) për vitin 2023.
9. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur.
10. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
11. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
12. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 14 të ligjit për Media.
13. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për SHTR PROTEL SHPKNJP Probishtip për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
14. Propozim për iniciim të procedurës për kundërvajtje kundër SHTR Alsat-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi.
15. Propozim për iniciim të procedurës për kundërvajtje kundër Njësisë organizative jofitimprurëse të transmetimit RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 – Universiteti „Shn. Kirili dhe Metodi“ – Shkup për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
16. Propozim – vendim për pagesë për kompensim për vdekje të anëtarit të familjes.
17. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike për KABLEKAL nga Kërçova, për shkelje të nenit 143 paragrafi (2) të LSHMAAV, me propozim-informacion drejtuar organit përgjegjës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është bërë shkelje.
18. Propozim për marrjen e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit Total TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.
19. Propozim-informacion drejtuar organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është kryer shkelja e tyre.
20. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e seancës së 44-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 5.12.2022, me tekst siç ishte propozuar.

Pikat 2, 3 dhe 4

Z.Trajçevski e arsyetoi (shpjegoi) Propozim-planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore për vitin 2023, Propozim-planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për vitin 2023 година dhe Propozim-programin për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 (me Propozim-programin e planifikuar të aktiviteteve dhe Propozim-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023). Ai shpjegoi se këto dokumente paraprakisht janë sjellë nga Këshilli si draft version dhe më pas është hapur senca publike e cila ka zgjatur deri më 18 dhjetor. Vërejtje lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve nuk janë paraqitur gjatë seancës publike, përveç se ASHMA-ja ka bërë ndryshim në pjesën e Planit Financiar për faktin se disa furnizime publike në këtë vit nuk janë realizuar dhe janë transferuar për vitin e ardhshëm 2023. Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm duhet të rriten në përputhje me rrethanat. Në atë drejtim, të hyrat e përgjithëshme do të arrijnë në 148.530.505,00 denarë sa do të jenë dhe shpenzimet, dhe arsye për këtë, siç u tha janë furnizimet publike që nuk janë realizuar plotësisht këtë vit dhe pagesa do të bëhet gjatë vitit 2023.

Z.Petrushevski tha se përveç këtij ndryshimi në Planin Financiar, nuk ka ndryshime të tjera, e as nuk ka pasur vërejtje nga publiku apo palët e interesuara gjatë seancës publike. Ai ka deklaruar se do të mbështesë dokumentet dhe se qëndrimi i tij ka qenë i njëjtë me atë kur janë propozuar si draft dokumente.

Z.Ajdini tha se palët e interesuara nuk kishin dorëzuar asnjë vërejtje dhe ai gjithashtu nuk ka vërejtje për përmbajtjen e tre dokumenteve. Ai deklaroi se do të mbështesë propozimet dhe vlerësoi përpjekjet që kanë bërë punonjësit për përgatitjen e këtyre dokumenteve.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore për vitin 2023, me tekst siç ishte propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm duhet ta publikojë në ueb – faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për vitin 2023, me tekst siç ishte propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm duhet ta publikojë në ueb – faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëti miratoi Programin për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 (me Programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023), me tekstin siç ishte propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin për punë të lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb – faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e ndihmës financiare (donacion) për transmetuesit për vitin 2023, në vlerë prej 25% të tarifës për leje. Ai sqaroi se në pajtim me Konkluzionin e Këshillit nga seanca e 36-të, mbajtur më 29.9.2022 për dhënien e ndihmës financiare transmetuesve për vitin 2023, në vlerë prej 25% të tarifës për leje që atakanë për transmetim në televizion dhe radio, është propozuar të miratohet Vendim përkatës për të gjithë transmetuesit të cilët në momentin e marrjes së vendimit kanë licencë për transmetim televiziv ose radio në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai informoi se gjatë ditës para mbajtjes së kësaj seance është mbajtur takim me kryetarin dhe drejtorin e ZNM-së dhe përfaqësues të tjerë nga shoqata të cilët kanë pyetur nëse Ligji do të zbatohet në tërësi dhe ASHMA-ja do t'i marrë mjetet e plota që sipas Ligjit duhet të jenë prej 1%, nëse në një rast të tillë Agjencia do t'i ndihmonte sërish transmetuesit. Në atë drejtim, ai u përgjigj se nëse ka ribalanc të buxhetit dhe Qeveria ia paguan mjetet në tërësi ASHMA-së në masë siç është parashikuar në Ligj, Agjencia me siguri do ta korrigojë këtë vendim prej 25% ndihmë financiare gjegjësisht përqindja do të jetë më e lartë. Agjencia për të mbuluar punën, përdor fondet e kursyera nga vitet e mëparshme, kështu që ky donacion prej 25% për ASHMA-në paraqet shpenzim. Ai theksoi se nëse nuk do të ishin fondet që ka kursyer Agjencia nuk do të mund të funksiononte si institucion dhe për këtë arsye nuk mund të lejohet të donojë fonde më të larta financiare nga përqindja e propozuar. Ai ka theksuar edhe njëherë se nëse me ribalancin e buxhetit, Qeveria i paguan mjetet që me ligj i janë borxh Agjencisë, do të ketë ndihmë shtesë për transmetuesit.

Z. Fidanoski tha se me siguri ASHMA-ja do të paraqitet për të rritur mbështetjen ndaj të gjithë transmetuesve dhe se ai personalisht do të inkurajohet të thotë se me siguri do të jetë dhe tre herë më shumë se përqindja aktuale, por vetëm me kusht nëse merren 6% nga buxheti që sipas Ligjit i përkasin ASHMA-së.. Sipas përlllogaritjes së tij të përafërt, do të ishte rreth 2 milionë e gjysmë euro në denarë, që do të thotë se nuk është asnjë problem për Agjencinë të japë mbështetje shtesë. ASHMA-ja edhe pa këto mjete 3 vjet me 100% i ka liruar transmetuesit nga pagesa e tarifës vjetore të lejes, pastaj vitin e katërt 50%, tani 25%. Ai përmendi edhe njëherë se nuk është asnjë problem, por vetëm me kusht që Agjencisë t'i paguhen të gjitha mjetet që i detyrohen me Ligj.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratim drejtorit që të marrë Vendim për dhënien e ndihmës financiare (donacion) për transmetuesit për vitin 2023, në vlerë prej 25% të tarifës për leje.

Për ndihmën financiare (donacion) të lartpërmendur, do të lidhet kontratë ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe transmetuesve të cilët në momentin e miratimit të vendimit kanë leje për transmetim televiziv dhe radio në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët kontraktuese dhe do të zbatohet (qplikohet) pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb – faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes të SHTR TV Iris nga Shtipi. Ai ka shpjeguar se të gjithë transmetuesit që kanë marrë leje për transmetim në televizion dhe radio duhet të plotësojnë edhe kushtet e Rregullores për teknikat minimale,

hapësinore dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim në televizion dhe radio. Ai theksoi se TV Iris, fatkeqësisht, ka një kohë të gjatë që po përballet me probleme serioze në punën e tij, gjë që ka bërë Këshilli disa herë të nisë procedurë për heqjen e lejes. Këtij transmetuesi i është kërkuar të dorëzojë dokumentacion se i plotëson kushtet minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregullore, por transmetuesi nuk i ka dorëzuar, gjë që tregon se nuk i plotëson kushtet.. Për këtë arsye sugjerohet që Këshilli të iniciojë procedurë. Ai ka shpjeguar se për shkak të rritjes së detyrimeve të punës nuk ka mundur t'i shqyrtojë e-maillet që transmetuesi i ka dorëzuar sot, por është njoftuar nga udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat autoriale se dokumentacioni që i është dërguar është i papërshtatshëm.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat autoriale mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka sqaruar se gjatë ditës së djeshme TV Iris përmes e-mailit në Agjenci ka dorëzuar dokument që nuk është adekuat për të dëshmuar se i plotëson kushtet minimale kuadrovike. Gjithashtu, gjatë ditës së sotme kanë dërguar disa e-maile, dy prej të cilëve ishin bosh pa dokumente të bashkangjitura, dy ishin teknikisht të pamundur për t'u hapur, ndërsa tani derisa po zhvillohet seanca ka mbërritur një tjetër e-mail me dokumente që mund të hapen, por në këtë moment nuk mund të bëhet kontroll i detajuar i dokumenteve për të konstatuar nëse janë dokumentet e nevojshme dhe nëse janë në rregull.

Z.Petrushevski e pyeti udhëheqësen nëse ka mundësi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës me shpresën se dokumentacioni i dorëzuar është në rregull?

Z. Ajdini propozoi që pika të lihet si pikë e fundit për këtë Rend dite, ndërsa udhëheqësja ndërkohë të shqyrtojë dokumentacionin.

Z.Trajçevski tha se kjo është çështje serioze dhe se dokumentet e kërkuara nuk janë të tilla që të mund të shikohen dhe kontrollohen shpejt. Ai tha se fillimi i procedurës nuk do të thotë heqje e lejes sepse transmetuesi ka kohë 15 ditë për të harmonizuar veprimtarinë e tij me Ligjin. Afatet nisin nga dorëzimi i propozimit në arkiv dhe për këtë arsye shtyrja e pikës për seancën e radhës nuk do të thotë asgjë sepse afatet janë ende në rrjedhë.

Udhëheqësja Davidovska Dovleva sqaroi se shkresën e parë me të cilën Agjencia ka kërkuar nga transmetuesi të dorëzojë dokumente nga të cilat mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kuadrovike e kanë pranuar më 13.10.2022. Ata nuk vepruan sipas kërkesës dhe për këtë arsye iu dërgua dhe një shkresë tjetër të cilën e kanë pranuar më 10.11.2022. Ndërkohë, ajo pati disa biseda telefonike të pasuksesshme për t'u shpjeguar më konkretisht se cilat dokumente duhet të dërgonin. Më 23.11.2022 , të njëjtat shkresa iu dërguan sërish me e-mail. Ajo ka thënë se i gjithë ky proces ka vazhduar që nga 13 tetori i këtij viti dhe tani në këtë moment derisa po mbahet seanca, Agjencisë i ka ardhur e-mail me dokumente që duhet të shqyrtohen.

Z.Fidanovski u pajtua se duhet që të fillohet procedurë për heqjen e lejes, sepse transmetuesi do të ketë kohë të mjaftueshme për të harmonizuar veprimtarinë e tij me Ligjin ndërsa udhëheqësja nuk do të jetë nën presion, ajo do të ketë kohë të mjaftueshme gjatë javës për të shqyrtuar e-maillet dhe dokumentet në detaje dhe nëse çdo gjë është në rregull do të mbahet seancë në të cilën do të ndërpritet procedura e nisur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR Televizionit ИПИС SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015 për shkelje të nenit 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk dorëzon dokumentacionin e nevojshëm nga i cili do të mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kuadrore të përcaktuara në Rregulloren, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimin të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të miratoj Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizionit IRIS SHPK Shtip, me PA1 nr.08-902 datë 8.7.2015.

Pikat 7 dhe 8

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozim-planin vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMA-së) për vitin 2023 dhe Propozim-planin vjetor për vlerësimin e rrezeve nga korrupsioni të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMA-së) për vitin 2023. Lidhur me Pikën 7, ajo shpjegoi se plani është miratuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të interesit 2021-2025 miratuar nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Bazuar në këtë, Agjencia ka miratuar Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2021 dhe 2022, që do të thotë se ky do të jetë viti i tretë që përgatitet një plan i tillë. Në këtë dokument, përveç qëllimeve që duhen arritur, masave dhe aktiviteteve, ka edhe një përmbledhje të aktiviteteve dhe masave të realizuara nga Planin Vjetor për parandalimin e korrupsionit për vitin 2022, nga ku shihet se të gjitha masat që ishin paraparë në atë aktivitet janë zbatuar. Dhe në këtë propozim (draft) dokument ka aktivitete që duhet të kryhen vitin e ardhshëm duke përcaktuar periudhën kohore dhe kush janë subjektet nga të cilat duhet të kryhen ato aktivitete. Në lidhje me Pikën 8, ajo shpjegoi se ky dokument për herë të parë është miratuar në vitin 2022 në pajtim me Projekt-procesverbalin e Qeverisë nga seanca e 55-të. Në të janë definuar fushat ku mund të ketë rreze të caktuara për korrupsion, si integritet individual dhe institucional, cilësia në punën e Agjencisë, trajtimi i raportimeve për parregullsi dhe raportime nga sinjalizues, furnizime publike dhe konflikte interesi gjatë realizimit (zbatimit) të mbikëqyrjes.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që drejtori i Agjencisë të miratojë Planin vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, me teks siç ishte propozuar.

Sektorin për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, dokumentin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që drejtori i Agjencisë të miratojë Planin vjetor për vlerësim të rrezeve nga korrupsioni të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, me tekst siç ishte propozuar.

Sektorin për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, dokumentin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike në afat prej 5 ditësh nga dorëzimi i Planit vjetor për vlerësim të rreziqeve nga korrupsioni të dërgojnë njoftim në Zyrën (Kabinetin) e zëvendës kryetarit të Qeverisë në RMV kompetent për politikat e udhëheqjes së mirë drejtë. дена од донесување на Годишниот план за проценка на ризици од корупција да достават известување до Кабинетот на заменик на претседателот на Владата на РСМ задолжен за политики на добро владеење.

Pikat 9, 10, 11 dhe 12

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska, i shpjegoi propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV, të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV dhe për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media. Ajo ka sqaruar se këto shkelje janë konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e kryer në muajin nëntor të këtij viti. Shkelja e parë është për rregullat për mbrojtjen e personave të mitur. Në ditën kur është bërë mbikëqyrja, televizioni ka transmetuar film artistik dhe film të animuar pa shenjën e detyrueshme paralajmëruese dhe pa shenjë të përshtatshme klasifikimi. Shkelja e dytë ka të bëjë me informacionin që transmetuesi është i detyruar t'i vërë në dispozicion përdoruesve. Bëhet fjalë për emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel, adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual, të dhënat për kontakt (numri i telefonit, adresa e postës elektronike e-mailit dhe/ose ueb-faqes; - personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent. Shkelja e tretë i referohet nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, gjegjësisht detyrimit për transmetimin e së paku 30% të veprave audiovizuele maqedonase në baza ditore, gjysma e të cilave duhet të transmetohen nga ora 7 deri në orën 19. Ditën kur është bërë mbikëqyrja, transmetuesi kishte vetëm 4% vepra audiovizuele maqedonase. Shkelja e fundit i referohet nenit 14 të Ligjit për media, gjegjësisht bëhet fjalë për detyrimin për publikim impresium. Ditën kur është realizuar mbikëqyrja, disa programe të prodhimit të huaj janë transmetuar pa publikuar impresium. Për të katër shkeljet, propozohet që Këshilli të marrë vendim për shqiptimin e e masës vërejtje publike. Për tre shkeljet e para sipas Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, afati për harmonizim (respektim) është 30 ditë, ndërsa për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media, afati për harmonizim (respektim) është 45 ditë.

Z.Ajdini tha se nga materialet rezulton se transmetuesi nuk ka paraqitur deklaratë për shkeljet e bëra. Në këtë drejtim, ai pyeti nëse media është kontaktuar dhe nëse kanë informacion për arsyet e shkeljeve? Ai theksoi se ky transmetues i takon grupit të transmetuesve që nuk nuk janë mbikëqyrur për një kohë të gjatë, siç ishte rasti për TV Dibra, TV Zdravkin e të tjerë, të cilët ishin objekt i shqyrtimit në seancat e mëparshme.

Udhëheqësja Janevska tha se nuk i kujtohet nëse transmetuesi ishte i pranishëm në trajnimin që u organizua në Tetovë.

Z.Ajdini tha se në atë trajnim ishte i pranishëm një përfaqësues nga TV Kaltrina.

Udhëheqësja Janevska tha se është realizuar komunikim me transmetuesin për shkak se ka pasur problem me dorëzimin e raporteve të mbikëqyrjes, por nuk ka informacion nëse kolegët e sektorit kanë njohuri për arsyet pse kanë ndodhur shkeljet.

Z. Ajdini tha se ky transmetues punon si medium për një kohë shumë të gjatë, gati 30 vite dhe për të është pak e paqartë pse ka bërë shkelje të tilla.

Votimi për pikën 9

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4435/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP t'i shqiptoj masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur sepse më 8 nëntor 2022, në filmin artistik „Shteti i 51-të“ dhe filmi i animuar „Miki Maus“, janë transmetuar pa sinjalizimin e duhur paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Në përputhje (pajtim) me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me LSHMAAV dhe Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 10

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative me nr.10-4447/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri konstatoi për SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 8 nëntor 2022, nuk ka siguruar informacionin që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, është urdhëruar në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 11

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.10-4433/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 8 nëntor 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as së paku gjysmën nga minimumi ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që transmetonte në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës vërejtje publike me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, është urdhëruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e neit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike të transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 12

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.10-4446/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media, sepse më 8 nëntor 2022, në pjesë të programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmetojë në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje nga shërbimi programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje masë me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendimin për shqiptim të masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 13

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR PROTEL SHPKNJP Probishtip për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e realizuar në nëntor të këtij viti. Neni 64 i referohet detyrimeve në lidhje me gjuhën në të cilën duhet të transmetohet programi. Ditën kur është kryer mbikëqyrja është konstatuar se në një emision, deklaratat e këngëtares janë transmetuar fillimisht në gjuhën serbe në vend që të përkthehen në gjuhën maqedonase. Këshillit iu dha propozim, që të miratoj Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike me afat respektimi prej 15 ditësh. Ky transmetues ka kërkuar falje për shkeljen me të cilën thonë se zakonisht e rishikojnë programin nga prodhim i huaj, por në rastin konkret kanë bërë një anashkalim dhe se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm sa i përket gjuhës.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4434/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri konstatuan se ndaj SHTR PROTEL SHPKNJP Probishtip t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 4 nëntor 2022, deklarata e këngëtares Milica Pavloviq në emisionin „Nasha scena“, është transmetuar fillimisht në gjuhën serbe, pa siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në përputhje me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim siaps aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (tekst i pastruar) me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 14

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR Alsat-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi. Ajo ka shpjeguar se kjo shkelje është konstatuar nga mbikëqyrja e kontrollit pasi më 4 nëntor i është shqiptuar masë vërejtje publike për të njëjtën shkelje. Gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se në më shumë edicione të serialeve artistike ishin transmetuar pop-ap/reklama me ekran të ndarë që mbulonin pjesë thelbësore të aksionit – personazhet. Është propozuar që të inicohet procedurë për kundërvajtje, por pas analizimit të materialit, kolegët e Sektorit për çështje juridike kanë konstatuar se ashtu si neni 92 paragrafi (3) nuk ka dënim për këtë dispozitë ligjore në LSHMAAV. Nga këtu nuk mund të realizohet iniciimi i procedurës për kundërvajtje.

Z. Petrushevski sqaroi se Këshilli nuk ka zgjidhje dhe duhet të miratojë masën e propozuar.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor me nr.10-4440/1 datë 29.11.2022 ndaj SHTR Alsat-M SHPK Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër SHTR Alsat-M SHPK Shkup të inicojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja e kontrollit është konstatuar se më 22 nëntor 2022, në edicionet e serialeve artistike „Zemra e plagosur“, „Çakër-familja e madhe“, dhe „Mos më braktis“, si dhe në programet aktuale informative „Pasdite“ dhe „Programi 200“, disa herë u transmetuan pop-ap/reklama në ekran të ndarë që mbulojnë pjesë thelbësore të veprimit – personazhet.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 15

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për marrjen e procedurës për kundërvajtje kundër Njesisë Organizative Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 – Universiteti „Shn. Kirili dhe Metodi“ – Shkup për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar me mbikëqyrje të rregullt, por këtu është propozuar që të inicohet procedurë për kundërvajtje sepse për transmetuesin mbi të njëjtën bazë është shqiptuar masë vërejtje publike në fillim të vitit 2022. Në këtë rast është shkelur neni 51 paragrafi (1) të LSHMAAV për shkak se transmetuesi nuk ka ofruar (siguruar) informacionet që është i detyruar t'i vë në dispozicion të përdoruesit

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative me nr.10-4617/1 datë 15.12.2022 të RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 – Universitet „Shn. Kirili dhe Metodi“ – Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli me 5 vota „për“ dhe një abstenim nga z.Jançeski konkludoi kundër RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 – Universiteti „Shn. Kirili dhe Metodi“ – Shkup të inicojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrje u konstatua se më 2 dhjetor 2022, nuk ka siguruar informacion që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesit (shfrytëzuesit).

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 16

Këshilli i Agjencisë dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për pagesën e ndihmës financiare – kompensim për vdekjen e anëtarit të familjes më të ngushtë (babait), punonjësit të caktuar në vendin e punës Punëtor Kuzhine në Njesisë për punë të përgjithëshme të Sektorit për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në vlerë prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet e lartpërmenduar janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.

Pika 17

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Kablekall nga Kërçova, për shkelje të nenit 143 paragrafi (2) të LSHMAAV, me propozim-informacion organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është kryer shkelje. Ajo ka shpjeguar se më 16 dhjetor të këtij viti në Agjencion ka mbëritur (marrë) njoftim nga HAYAT d.o.o se kanë inspektuar shërbimet programore të regjistruara që Agjencia i publikon në ueb-faqe dhe kanë konstatuar se shërbimet e tyre programore janë regjistruar në gjithësej 7 operatorë, dhe asnjë prej tyre nuk ka leje për ritransmetimin e tare. Ajo deklaroi se Sektori menjëherë që ditën e nesërme të punës dhe gjatë këtyre ditëve që po sigurohen sinjalet ka kryer mbikëqyrje mbi të 7 operatorët, por vetëm tek ky operator është konstatuar se ka transmetuar ilegalisht shërbimin e programit „Hayat“. Në pajtim me konstatimet, është propozuar që t'i shqiptohet masë vërejtje publike dhe të urdhërohet që menjëherë të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore pa rregulluar të drejtat autoriale dhe ndërkohë të njoftohet organi kompetent që të veprojë në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore, me nr.11-4673/1 datë 19.12.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj operatorit të rrjetit publik për komunikim elektronik Shoqërisë për Telekomunikacion dhe softuer-operator kabllor KABLEKALL eksport-import SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 143 paragrafi (2) të LSHMAAV sepse nga mbikëqyrja u konstatua se operatori për përdoruesit (shfrytëzuesit) e tij ritransmeton shërbimin programo „Hayat“ për të cilën, siç shihet nga njoftimi i dorëzuar në HAYAT d.o.o. nuk ka të rregulluar të drejtën e autorit në pajtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta. согласно Законот за авторското право и сродните права.

Këshilli i Agjencisë njëzëri konkludoi drejtuar Ministrisë të Punëve të Brendshme – Qendrës për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe të Rëndë që t'i dorëzojë informacionin për dyshimin e ekzistimit për shkelje të kryer të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta nga ana e operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqërisë për Telekomunikacion dhe Softuer- operator kabllor KABLEKALL eksport-import SHPKNJP Kërçovë, me teks siç ishte propozuar.

Operatori i lartpërmenduar është udhëzuar menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht të ndalojë ritransmetimin e shërbimeve programore pa rregulluara të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 18

Z.Trajçevski e shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit Total TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV. Ai shpjegoi se operatorët janë të obliguar që t'i ritransmetojnë shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv. Ky operator satelitor nuk bën ritransmetim të vazhdueshëm të shërbimeve programore „MRT 2“, „MRT 3“, „MRT 4“ dhe „MRT 5“. Arsyetimi i tij është se kjo ka ndodhur për arsye financiare. Meqënëse kjo dispozitë e Ligjit nuk është respektuar disa herë gjatë vitit, propozohet që të fillohet procedurë për kundërvajtje.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt programore me nr.11-4671/1 datë 19.12.2022 të Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, dhe ka konstatuar shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri ka konstatuar kundër Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup që të ngrejë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente për shkak se mbikëqyrja ka konstatuar se operatori në fjalë i rregullt publik të komunikimit elektronik i cili sipas njoftimit (notifikacionit) nga Agjencia për komunikime elektronike mund të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në paketën e tij programore, nuk ka ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, përkatësisht nuk i ritransmeton shërbimet programore „MRT 2“, „MRT 3“, „MRT 4“ dhe „MRT 5“, që bie në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

Pika 19

Z.Trajçevski e shpjegoi Propozim-informacionin drejtuar organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është bërë shkelje e tyre. Ai ka shpjeguar se gjatë ditës së djeshme në orët e pasdites dhe mëngjesin e sotëm kanë mbërritur materiale plotësues dhe një Kërkesë nga TV Kanal 5 për iniciimin e procedurës ndaj të njëjtit operator Total TV për shkak të pretendimit për shkelje të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta nga ana e tij. TV Kanal 5 dërgoi materiale të shumta, për të cilat realisht nuk kishte kohë për t'u shqyrtuar, por megjithatë kjo është detyrë e MPB dhe Prokurorisë Publike nëse ka shkelje, të ndërmarrin veprimet e duhura.

Z.Petrushevski tha se në propozimin e dorëzuar në materialet thuhet se operatori është EON TV International Ltd, Limassol Kipar dhe jo TOTAL TV. Ai po ashtu tha se në këtë rast Këshilli nuk merr asnjë masë, por ia përcjell dokumentacionin organit kompetent.

Z. Trajçevski sqaroi se bëhet fjalë për ndonjë platformë të TOTAL TV.

Këshilli i Agjencisë, në bazë të kërkesës së pranuar për iniciimin e kallëzimit penal tek organet kompetente nga ana e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KANAL 5 SHPKNJP Shkup (Nr.yne.03-4694/2 datë 21.12.2022) me të cilën kërkojnë në afat sa më të shkurtër kohor të paraqitet kallëzim penal në prokurorinë publike kompetente kundër personit juridik operator EON TV International Ltd, Limassol Kipar, njëzëri ka miratuar konkluzionin drejtuar Ministrisë për Punë të Brendshme – Qendrës për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe të Rëndë të dorëzojë informacionin për ekzistimin e dyshimit për shkelje të kryer të së drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta nga ana personit juridik operator EON TV International Ltd, Limassol Kipar, me teks siç ishte propozuar.

Pika 20

Të ndryshme

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

Nr.02-83/1

10.01.2022

Shkup

Agjencia për Shërbime

**Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v